

**PROF. ASOC. DR. GJON BORIÇI**

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë  
Gjon.Borici@akad.gov.al

**DIMENSIONI I LUFTËS BRENDA LLOJIT DUKE PËRDORUR  
SIGURIMIN E SHTETIT GJATË REGJIMIT KOMUNIST  
NË SHQIPËRI  
(1947 – 1953)**

**Abstrakt:**

*Studimi i epokës së Sigurimit të Shtetit në Shqipëri përgjatë epokës komuniste, edhe pas më shumë se 30 vjetëve tranzicion që po kalon vendi ynë, mbart ende recidiva të mëdha. Strukturat e sigurisë në çdo vend të botës kanë pasur përherë vëmendjen e studiuesve, analistëve dhe asaj pjese të interesuar të opinionit publik. Në vendin tonë, studimi i Sigurimit të Shtetit dhe i angazhimit të kësaj strukture famëkeqe në jetëgjatësinë e sistemit komunist në Shqipëri ka një rëndësi të veçantë. Artikulli që po paraqesim synon të analizojë mënyrën se si lidërshtipi më i lartë komunist në Shqipëri përdori strukturat e Sigurimit të Shtetit për të goditur kundërshtarët e tij brenda vetë sistemit. Lufta brenda llojit në Partinë Komuniste Shqiptare (pas vitit 1948, Partia e Punës e Shqipërisë) nuk ndryshonte shumë nga ajo që zhvillohej në vendet e tjera anëtare të Kampit Socialist. Megjithatë, në vendin tonë, zvetënimimi dhe deformimi i gjithçkaje që kishte të bënte me "t'i bësh qejfin" udhëheqjes dhe me përfitimin e favoreve nuk njihete asnjë kufi. Duke analizuar luftën brenda llojit në sistemin komunist në Shqipëri dhe angazhimin e strukturave të Sigurimit, arrijmë të kuptojmë dallimin e thellë ndërmjet ndërgjegjes dhe djallëzisë, moralit dhe poshtërsisë – një luftë që u shndërrua në doktrinë. Artikulli bazohet kryesisht në dokumente arkivore autentike, fryt i një pune të gjatë në arkivat e shtetit shqiptar, si edhe në literaturën më të përzgjedhur kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo literaturë mbështetet në një metodologji analitike të hollësishme për shqyrtimin e ngjarjeve kryesore që shënuan jetëgjatësinë e 45 vjetëve të një pushtetit politik të paskrupullt.*

**Fjalë kyç:**

*Shqipëri, Sigurimi i Shtetit, goditje, Enver Hoxha, Mehmet Shehu, Koçi Xoxe, eliminime.*

**Hyrje**

Ndërtimi i "njeriut të ri" apo *homo sovieticus* do të rezultonte fatal për Shqipërinë. Hapja e kampeve famëkeqe të punës së detyruar dhe burgosjet e gjata ishin "kartëvizita" e sistemit. Vetë fizikani dhe akademiku i famshëm sovjetik Andrei Sakarov, teksa fliste mbi papërcaktueshmërinë e natyrës dhe çështjeve njerëzore, i ka përshkruar "gulagun" apo kampet e punës si "vende ku jeta njerëzore nuk kishte asnjë lloj vlere dhe çdo gjë njerëzore nuk ekzistonte"<sup>1</sup> Eksperiencia sovjetike e eliminimit të kundërshtarëve brenda llojit dhe e persekutimit të popullsisë do të kopjohej me një zell të madh. Lufta brenda llojit në kontekstin e identitetit komunist shqiptar do të merrte përmasa jashtëzakonisht të dhunshme, duke shkuar përtej çdo kufiri të arsyes njerëzore. Struktura më e frikshme e mbrojtjes së pushtetit në Bashkimin Sovjetik ishte KGB-ja\*. Në Shqipëri, ekuivalenti i saj ishte Sigurimi i Shtetit. Me miliona njerëz në Bashkimin Sovjetik dhe me mijëra në Shqipëri do të vuanin pasojat e këtyre strukturave të frikshme të regjimit – një histori për të cilën, deri më sot, ende mungon një studim i mirëfilltë shkencor. Mohimi dhe sakrifikimi i çdo vlere njerëzore nga ana e kësaj strukture monstruoze ishte tipari dallues i sistemit. Në këtë artikull do të ndalemi tek elementët dhe ngjarjet që përcaktuan pushtetin jetëgjatë të Enver Hoxhës: nga vetëvrasja e Nako Spirut, eliminimi i Koçi Xoxes,

<sup>1</sup> Jay Bergman, *Meeting the demands of reason; the life and thought of Andrei Sakharov* (New York: Cornell University Press, 2009), 308.

\* Komitet Gosudarstvennoy Bezopasnosti [Komiteti për Sigurinë Shtetërore], i njohur si KGB, mori këtë emër në vitin 1954 dhe u krijua si vijimësi e Cheka-s (VCHEKA - Komisioni i Jashtëzakonshëm i të gjitha Rusive për Luftën Kundër Kundërrevolucionit dhe Sabotazhit), i themeluar më 1917.

deri te goditja e parë ndaj Mehmet Shehut në vitin 1953 – të gjitha të urdhëruara nga pushteti dhe të ekzekutuara me besnikëri nga strukturat e Sigurimit të Shtetit.

### **Goditjet e para të luftës brenda llojit**

Goditjet e para të luftës brenda llojit u shfaqën me eliminimin e ministrit të Ekonomisë, Nako Spiru, në nëntor të vitit 1947. Arsyet e këtij eliminimi janë trajtuar në mënyrë të hollësishme në një artikull timin të botuar në revistën "Studime historike".<sup>2</sup> Megjithatë, lufta më e dukshme dhe më e ashpër brenda llojit do të shfaqej pas prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave dhe kalimit të plotë të Shqipërisë nën tutelën e Bashkimit Sovjetik. Më datë 26 qershor 1948, komiteti qarkor i Shkodrës i dërgoi një shkresë Degës së Sigurimeve Shoqërore të rrethit, ku kërkohej informacion mbi të gjithë nëpunësit, biografinë e tyre dhe, mbi të gjitha, qëndrimin politik.<sup>3</sup> Raporti duhej të ishte i plotë, duke përfshirë çdo person dhe duke e kategorizuar qartë si "pro" ose "kundërshtar".<sup>4</sup>

Përndjekja nuk kurseu as komunistët që shërbenin në këtë strukturë dhe as agentët e Sigurimit. Ka pasur edhe raste vetëvrasjesh, si rasti i Sh. M. në Konispol, i cili, në letrën që la, shpjegonte se po e kryente këtë akt, sepse e dinte se do të arrestohej.<sup>5</sup> Në fund të letrës, operativi lutej që, për shkak të këtij veprimi, e shoqja dhe familjarët të mos përballeshin me pasoja shoqërore dhe politike.<sup>6</sup> Gjithashtu, disa anëtarë të Sigurimit i dërgonin letra Komitetit Qendror në Tiranë, duke

<sup>2</sup> Gjon Boriçi, "Një vështrim në terma politiko-ekonomikë ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë në periudhën 1945-1949 (Pjesa e dytë, korrik 1947 – mars 1948), në *Studime historike*, nr. 2 (2023): 133-155.

<sup>3</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 14/Strukturat (më tej: Str), Viti (më tej: V.) 1948, Dosja (më tej: D.) 172, fleta (më tej: fl.) 3. Korrespondencë ndërmjet komiteteve të partisë në rrethe dhe Komitetit Qendror të PKSH-së lidhur me kërkesën e Prokurorisë së Përgjithshme për listat e anëtarëve të partisë dhe të nëpunësve, sipas listave të Sigurimeve Shoqërore.

<sup>4</sup> *Po aty*, fl. 2. "Në shtyllën ku thotë kundërshtarë, do të shënohet elementi që asht kundërshtar, urren vijën e Pushtetit, nuk shkon në konferencë, hedh parrulla, me cilët elementë ka relacion, në qoftë se i ka marrë reforma tokat, shtëpitë, dyqanet etj".

<sup>5</sup> *Po aty*, F. 14/Str, V. 1948, D. 410, fl. 1. Raport i organizatës bazë nr. 26, dërguar Komitetit Qendror të PKSH-së mbi vetëvrasjen e Sh. M., së bashku me kopjen e letrës së lënë para vdekjes.

<sup>6</sup> *Po aty*, fl. 1-2.

raportuar për pushkatimet pa gjyq të njerëzve, të kryera me urdhër të Koçi Xoxes.<sup>7</sup>

Viti 1948 rezultoi fatal për Xoxen në detyrën e ministrit të Punëve të Brendshme. Vërtet ai kishte krijuar një strukturë të frikshme, por pas përkeqësimit të marrëdhënieve midis Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë, pozitat e tij filluan të dobësoheshin deri në fundin e tmerrshëm. Nga vetë strukturat e PKSH-së, madje edhe nga nivelet më të larta, vinin sinjale shqetësuese. Më 30 tetor 1948, Josif Pashko i shkruante prokurorit të Përgjithshëm të RPSH-së, Bedri Spahiu, një letër në të cilën shprehte shqetësimin për gjendjen e strukturave të Punëve të Brendshme dhe për përgjegjësinë e Koçi Xoxes për veprime në kundërshtim me ligjet dhe frymën e partisë. Ai madje theksonte se nga njerëzit e Sigurimit ishin kryer veprime që nuk diheshin nga instancat përkatëse.<sup>8</sup>

Në fakt, letrat nga të gjitha komitetet ekzekutive të rretheve kundër elementëve të Sigurimit të Shtetit kishin filluar të "vërshonin" në KQ që nga muaji janar 1948.<sup>9</sup> Shumica e tyre ishin plot e përplot me ankesa për kuadrot që punonin në këtë sektor, duke çuar në jo pak raste në marrjen e masave, madje edhe të rrepta, ndaj individëve të veçantë që nuk ofronin garancitë e duhura për të qëndruar në organet e Punëve të Brendshme.<sup>10</sup>

<sup>7</sup> *Po aty*, F. 14/Str, V. 1948, D. 469, fl. 1-2. Letër e kapitenit Mitat Zaçe, adresuar Komitetit Qendror të PKSH-së, lidhur me arrestimin dhe ekzekutimin pa gjyq të Skënder Çelës e Mark Toçit nga Durrësi, me urdhër të Koçi Xoxes. Sipas kapitenit Zaçe, për këto ekzekutime kishin dijeni edhe Beqir Balluku dhe Panajot Plaku. Për më gjerë, *shih*: Gjon Boriçi, "Pohimi nga Byroja Politike e PPSH të dhunës ndaj të burgosurve dhe internuarve nga organet e Sigurimit të Shtetit deri në vitin 1953", në konferencën shkencore ndërkombëtare, *Të mohuar nga regjimi; burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipërinë 1945-1990*, organizuar nga Autoriteti për Informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Tiranë, 30-31 tetor 2018.

<sup>8</sup> *AQSH*, F. 14/Str, V. 1948, D. 470, fl. 1-2. Letër e Josif Pashkos drejtuar Bedri Spahiut mbi gjendjen shqetësuese në Drejtorinë e Sigurimit të Shtetit, si rezultat i punës armiqësore që kishin zhvilluar Koçi Xoxe dhe mbështetësit e tij në këtë drejtim.

<sup>9</sup> *Po aty*, F. 14/Str, V. 1948, D. 489, fl. 1. Korrespondencë ndërmjet komiteteve të partisë në rrethe me Komitetin Qendror të PKSH-së, dhe anasjelltas, për propozime e emërimet kuadri në sektorin e Punëve të Brendshme dhe të Sigurimit.

<sup>10</sup> *Po aty*, fl. 7. Letër e Abaz Lazes, më datë 24 prill 1948, nga Komiteti i Partisë – Shkodër, lidhur me disa kuadro të Sigurimit në këtë qytet.

Nuk ishin të pakta rastet kur ishin shkarkuar edhe drejtues të agit-propit në rrethe, pasi kishin treguar frikë ndaj veprimeve të reaksionit.<sup>11</sup>

Fundi i vitit 1948 ishte një gjueti e vërtetë shtrigash. Së bashku me Koçi Xoxen filluan të goditeshin edhe figura të tjera të rëndësishme të misioneve shqiptare. Më 23 dhjetor 1948, Drejtoria e Kuadrit në KQ përpiloi një raport të hollësishëm lidhur me ish-Misionin shqiptar në Bari, nën drejtimin e Kadri Hoxhës.<sup>12</sup> Në atë raport, Kadri Hoxha cilësohej si njeri të cilit askush nuk guxonte t'ia vinte në diskutim fjalën dhe, mbi të gjitha, askush nuk duhej të dyshonte në veprimtarinë e tij dhe në punët që bënte.<sup>13</sup> Raporti shkante deri aty sa vinte në dyshim edhe zgjuarsinë e ish-shefit të misionit dhe shoqërimit të tij me njerëz të dyshimtë, si Llazar Apostoli, Xhemal Farka, Hito Sadiku etj., si dhe vuri në pikëpyetje besnikërinë e Hoxhës ndaj partisë.<sup>14</sup> Sipas këtij raporti, vihej në dyshim edhe moraliteti i Kadri Hoxhës, ku shkruhej se ai kishte marrëdhënie intime me një agjente të quajtur Tina, me pseudonimin "Flora", dhe se e kishte humbur fare pas saj, edhe pse e dinte se ishte agjente e SBS-së (në dokument nuk saktësohet çfarë përfaqësohte SBS), duke i shkruar gjithashtu poezi në italisht.<sup>15</sup> Një tjetër akuzë që i bëhej në këtë raport Kadri Hoxhës lidhej me abuzimet financiare që kishte kryer gjatë detyrës.<sup>16</sup> Megjithatë, edhe pse i bëheshin akuza të rënda, vetë hartuesi i raportit, Gafurr Çomo, tregohej i kujdesshëm kur shkruante se:

<sup>11</sup> *Po aty*, fl. 1-2, 8-9. Korrespondencë e Komitetit të Partisë të Rrethit të Mirditës për shkarkimin e anëtarit të plenumit dhe shefit të seksionit të agit-propit të këtij komiteti, Preng Ndue Prenga, pasi ishte frikësuar ndaj veprimeve të reaksionit në atë zonë. Shënpal, 19 mars 1948.

<sup>12</sup> *Po aty*, F. 14/Str, V. 1948, D. 512, fl. 1. Raport i Gafurr Çomos mbi gjendjen e ish-misionit ushtarak në Bari dhe mbi veprimtarinë e ish-shefit të misionit, Kadri Hoxha, duke përfshirë jetën e tij mondane dhe elementët spiunë që kishte marrë në shërbim në kuartierin e misionit.

<sup>13</sup> *Po aty*.

<sup>14</sup> *Po aty*, fl. 2.

<sup>15</sup> *Po aty*, fl. 4. Pjesë nga raporti për Kadri Hoxhën: "Kadriu e humbi ekuilibrin përpara kësaj femre dhe arrin të familjarizohet kaq tepër me të sa t'i shkruajë edhe një shaka të tillë: A la Signora Tina (Flora) Bari. Quando dormo sogno a te, quando mangio penso a te tra la la tra la la etc".

<sup>16</sup> *Po aty*, fl. 4-5. "Që të kemi një ide të përgjithshme mbi harxhimet e Kadriut për një të shkuar në Romë, mjafton t'ju jap si shembull se sa pa vend i harxhon ky njeri këto të holla. Blen për shembull një valixhe të madhe, por shumë luksoze që i kushtoi 100.000 lireta, blen tre kostume banjoje për vete, në vend që të blente një palë, me ngjyra të ndryshme; i blen edhe Zyrhasë dy pal kostume banjoje dhe kësaj me ngjyra të bukura

"...përsa i përket anës së tradhtisë dhe qëndrimit të tij anti shtet, kjo më duket se është një akuzë që për hir të së vërtetës duhet të merret edhe një herë në shqyrtim".<sup>17</sup>

Prishja me Jugosllavinë komprometoi rëndë shumë kuadro të PKSH-së; disa muaj pas këtyre ngjarjeve, figura e Nako Spirut ishte ndër më të degraduarat në radhët e partisë.<sup>18</sup> Muaji korrik 1948 ishte i sikletshëm për KQ në Tiranë, pasi, përveç goditjes së figurës së Spirut, kishin ardhur letra nga komitetet e partisë në rrethe, që njoftonin se ishin gjendur nën presion për të dekonspiruar dhe baltosur vetëvrasjen dhe figurën e udhëheqësit të lartë të PKSH-së.<sup>19</sup> Madje, vetë oficerët e Sigurimit tregonin në letrat e dërguara KQ-së se ishin shtrënguar nga shefat e tyre të hidhnin baltë mbi figurën e Nako Spirut për të gjetur edhe të "vërteta" sikur ai kishte qenë i rekrutuar nga policia fashiste që nga viti 1943.<sup>20</sup> Edhe për vdekjen e tij, ata ishin detyruar të pranonin se "vrasja kishte qenë aksidentale".<sup>21</sup>

Pas Kongresit I të PPSH-së dhe goditjes së figurës së Koçi Xoxes, filluan të shkruheshin letra të panumërta kundër figurës së ish-ministrit të Brendshëm dhe njerëzve të tij të afërt. Letrat janë të mbushura me informacion të panumërt se sa armiq të rrezikshëm paskësh mbajtur pranë vetes "armiku" Xoxe, që nga koha e luftës për çlirimin e Shqipërisë.<sup>22</sup>

dhe shumë luksoze, i blen Zyrhasë një sahat dore që i kushton lart nga njëzet mijë lireta (megjithëse çmimin e sahatit të tij dhe të Zyrhasë nuk e di me siguri se sa i kanë paguar)".

<sup>17</sup> *Po aty*, fl. 6. "Kadriu me gjithë fajet e tij ka mbajtur një qëndrim burrëror në Brindizi kur bataljonet e Financës Italiane kërkonin të kontrollonin materialin tonë ditën kur do linim Italinë. Gjendja atë ditë erdhi në çark dhe në përlëshje me armë. Kadriu nuk përulet, urdhëron që të zënë pozicionet e duhura, dhe të mos linim që ushtarët italianë të afroheshin në kamionët tanë. Çështja e zgjidh në favorin tonë dhe Komanda e Mesdheut urdhëron komandën e Brindizit që misioni ushtarak shqiptar të kalojë pa u kontrolluar".

<sup>18</sup> Shih gjerësisht Romeo Gurakuqi, *Shqipëria dhe Tokat e Lirume (1939-1946)*, botim i dytë i rishikuar (Tiranë: Jozef, 2023), 1439-1440.

<sup>19</sup> *AQSH*, F. 14/Str, V. 1948, D. 513, fl. 1. Korrespondencë e komiteteve të partisë në rrethe, ardhur në Komitetin Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, me anën e të cilave raportoheshin deklarata të disa komunistëve që tregonin presionet e ushtruara ndaj tyre për të komprometuar figurën e Nako Spirut dhe për të dekonspiruar rrethanat e vetëvrasjes së tij.

<sup>20</sup> *Po aty*, fl. 3.

<sup>21</sup> *Po aty*, fl. 5.

<sup>22</sup> *Po aty*, F. 14/Str, V. 1948, D. 515, fl. 1-37. Korrespondencë e komiteteve të partisë në rrethe dhe e Drejtorisë Politike të Ushtrisë për dërgimin e deklaratave dhe

Nga figurat më të spikatura që nuk vonuan të bënin "kthesë" pas goditjes së Xoxes dhe grupit të tij ishin Kadri Hazbiu, Abaz Fejzo, Jani Naska dhe Asim Aliko, të gjithë zyrtarë të lartë të Sigurimit të Shtetit. Në letrat që ata i shkruan Enver Hoxhës, nuk ngurruan të vinin në dukje besnikërinë e tyre ndaj partisë dhe, mbi të gjitha, ndaj atij vetë dhe sa keq ishin trajtuar nga Koçi Xoxe dhe njerëzit e tij kur ishin nën urdhrat e tyre.<sup>23</sup> Në letrën që Kadri Hazbiu i dërgoi Hoxhës më 25 tetor 1948, ai, përveç "shtrirjes barkas" në këmbët e Komandantit, duke hedhur poshtë çdo lloj dinjiteti personal, e mbyllte letrën me "përqafime" dhe theksonte se besimi i tij tek "Ai" dhe te partia nuk ishte lëkundur kurrë, me lutjen që, nëse do të kishte mundësi, "Ai" ta lexonte këtë letër me gjithë punët e tepërta që kishte.<sup>24</sup>

Letrat me akuza dhe fyerje ndaj "trockistit" Koçi Xoxe dhe grupit të tij "vërshuan" në Komitetin Qendror në adresë direkte të Enver Hoxhës. Në Arkivin Qendror të Shtetit ekziston një dosje e tërë me letra të një niveli skandaloz deri në neveri, pa asnjë lloj dinjiteti drejtuar Komandantit se sa armik i rrezikshëm kishte qenë Xoxe dhe partia kishte bërë shumë mirë që e kishte goditur.<sup>25</sup> Kishte edhe letra si ajo e anëtarit të partisë, Vasil Llazari (i arrestuar), dërguar nga burgu i "armiqve të popullit" për Tuk Jakovën, ku i kërkonte që t'i ndreqej padrejtësia që i ishte bërë nga njerëzit e Xoxes dhe vetë ai, pasi pas arrestimit ishte dënuar gabimisht me 15 vjet heqje lirie.<sup>26</sup>

informatave, me anë të të cilave njoftonin veprimtarinë e disa anëtarëve të partisë që kishin punuar në organet e Sigurimit gjatë kohës kur Koçi Xoxe ishte ministër i Brendshëm, si dhe deklaroheshin qëndrimi i keq politik i disa kuadrove gjatë periudhës së luftës.

<sup>23</sup> *Po aty*, F. 14/Str, V. 1948, D. 555, fl. 1-35. Letra nga Kadri Hazbiu, Asim Aliko, Jani Naska dhe Abaz Fejzo drejtuar Enver Hoxhës.

<sup>24</sup> *Po aty*, fl. 34-35. "Po mundët lexojeni këtë letër megjithë punët e tepërta që keni".

<sup>25</sup> *AQSH*, F. 14/Str, V. 1948, D. 557, fl. 1-144. Letra e lutje drejtuar Enver Hoxhës dhe Komitetit Qendror të Partisë nga anëtarë partie dhe punonjës të tjerë pa parti, me anën e të cilave tregonin trajtimin e keq që u ishte bërë gjatë kohës kur, në gjithë vendin tonë, sundonte vija trockiste e Koçi Xoxes dhe e pasuesve të tij: në drejtim dhe survejim, ndjekje të shokëve, mospërfillje të mendimeve të tyre, përbuzje, si dhe mosngritje në përgjegjësi sipas kapacitetit dhe aftësive të secilit.

<sup>26</sup> *Po aty*, F. 14/Str, V. 1948, D. 563, fl. 1-44. Letër e Vasil Llazarit, drejtuar Tuk Jakovës, në të cilën ai shkruante mbi veprimtarinë e tij si agent i anglo-amerikanëve dhe për persekutimin që i ishte bërë nga organet e Punëve të Brendshme si rezultat i asaj që quhej fryma e Koçi Xoxes, dhe kërkonte lirimin e tij dhe të shokëve nga burgu.

Goditja që iu dha Xoxes dhe njerëzve të tij të afërt, thellësisht të implikuar në krime për eliminimin e kundërshtarëve politikë në fillimet e regjimit dhe në luftën brenda llojit, u shoqërua edhe me tragjedi personale. I gjithë viti 1948 ka informacione të shumta lidhur me vetëvrasjet që kishin kryer agjentë të Sigurimit të Shtetit, pasi ishin etiketuar si pjesë e grupit të ish-ministrit të Brendshëm.<sup>27</sup> Megjithatë, kishte edhe zëra anonimë kundër goditjes që i ishte dhënë Xoxes. Në Tiranë (data nuk jepet në dokument), pranë Rrapit të Trishit, ishte gjetur një letër e hedhur në rrugë në favor të Koçi Xoxes, e cila fillonte me fjalët "Ne komunistët e Korçës....." ku akuzoheshin si tradhtarë uzurpuesit e partisë: Enver Hoxha, Mehmet Shehu, Haxhi Lleshi, Bedri Spahiu e të tjerë, dhe mbyllej me fjalët: "Rroftë Koçi Xoxe dhe komunistët e tjerë besnikë të popullit tonë të cilët sot janë mbyllur nëpër burgje".<sup>28</sup> Kjo letër duket se kishte tërhequr edhe vëmendjen e Enver Hoxhës vetë, i cili ka lënë shënimin e tij aty (në letër) me fjalët: "Kodoshllëqe të Jugosllavisë".<sup>29</sup>

Goditjet që po ndodhnin në Shqipëri gjatë gjysmës së parë të vitit 1948 ishin gjithashtu pasojë e informatave që qarkullonin nga të dërguarit për studime dhe specializime në Bashkimin Sovjetik, si studentë, ashtu edhe kuadro shqiptarë. Relacionet e Sigurimit mbi atë se çfarë diskutonin studentët shqiptarë në Moskë, lidhur me goditjet që kishin pësuar Nako Spiru dhe Liri Belishova, ishin të shumta.<sup>30</sup> Një nga informatat që sillte Sigurimi për KQ-në ishte edhe një bisedë e dy studentëve shqiptarë, të cilët më vonë do të bëheshin intelektualë të njohur në Shqipëri, Fatmir Gjata dhe Llazar Siliqi. Ata kishin thënë se:

<sup>27</sup> *Po aty*, F. 14/Str, V. 1948, D. 565, fl. 1-17. "Kopje letrash dhe radiograme e korrespondencë e Komitetit të Partisë të rrethit Sarandë me Komitetin Qendror të Partisë, e anasjelltas, në lidhje me vetëvrasjen e ish-anëtarit të partisë e n/shef i seksionit të punëve të brendshme, S. B., si viktimë e veprimtarisë trockiste të Koçi Xoxes, si dhe kopja e një letre drejtuar komisarit të Divizionit V mbi vetëvrasjen e rreshter Sh. M."

<sup>28</sup> *Po aty*, F. 14/Str, V. 1948, D. 618, fl. 3. "Një letër greqisht e shqip, për një gazetar anglez, dhe një fletushkë e shaptilografuar gjetur në orën 6:30 në mëngjes te Rrapi i Trishit në Tiranë, ku flitet për Koçi Xoxen (në favor të tij), ardhur nga Komiteti i Partisë i qytetit të Tiranës në Komitetin Qendror të Partisë".

<sup>29</sup> *Po aty*.

<sup>30</sup> *AQSH*, F. 14/Str, V. 1948, D. 543, fl. 1-8. "Informacione të Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit dhe të punonjësve të tjerë që kanë qenë në shërbim në Bashkimin Sovjetik, mbi studentët shqiptarë civilë dhe ushtarakë që studionin atje".

"Në Shqipëri nga neve do presin shumë, dhe do thonë se kemi dalë nga Universitetet dhe Institutet e Bashkimit Sovjetik, po nuk e dijnë ata se neve jemi rrotë.... Dhe s'kemi përfituar asgja më tepër sa ç'ishim".<sup>31</sup>

Madje, dy të rinjtë guxonin të bënin edhe dallime mes universiteteve perëndimore dhe atyre të BS-së<sup>32</sup> Nga raportet e Sigurimit lidhur me karakteristikat e studentëve dhe specializantëve shqiptarë që studionin në BS, shumica absolute e tyre ishin me origjinë të varfër fshatare dhe ish-partizanë.<sup>33</sup>

Në ndryshimet e reja që po ndodhnin në udhëheqjen e PKS-së, propaganda duhej të luante një rol edhe më të fortë në mbështetje të politikave të qeverisë komuniste nën drejtimin e Enver Hoxhës. Me një letër drejtuar redaksisë së re të gazetës "Zëri i Popullit" më datë 5 nëntor 1948, Kryeministri Hoxha uroi rifillimin e punës së kësaj gazete dhe "këshilloi" që ajo të vinte të gjitha forcat për të "çelnikosur në zemrat e popullit tonë dashurinë dhe besnikërinë për partinë dhe ndaj shpëtimtarit të lavdishëm të popullit tonë, Bashkimit Sovjetik".<sup>34</sup> Në fund të letrës, Hoxha nuk hezitoi të tregonte naivitetin e tij politik duke shkruar se "jeta dhe e ardhmja e lumtur e popullit shqiptar do të ishin të lidhura deri në vdekje me Bashkimin Sovjetik, pasi këtu qëndronte sigurimi më i madh që Shqipëria e re nën udhëheqjen e partisë do të ecte përpara dhe do të shkonte në socializëm".<sup>35</sup>

<sup>31</sup> *Po aty*, fl. 2. Informacion i datës 24 prill 1948: "Deri tashti me hollësi nga ky rreth nuk dijmë se çfarë bisedohet; po dijmë veç se nga Fatmir Gjata dhe Llazar Siliqi, duke qenë se këto kanë studjue edhe n'Itali, kur bajnë një krahasim me përfitimet që mund të ketë një i huaj n'Universitet thonë se: "Për një student të huaj që studion në shkollat e larta jashtë vendit të tij, p.sh., në këtë rast shqiptarët, përfitonin ma tepër nga Universitetet e ndryshme të vendeve të Perëndimit Itali, Francë sesa në këto të Bashkimit Sovjetik".

<sup>32</sup> *Po aty*.

<sup>33</sup> *Po aty*, F. 14/Str, V. 1948, D. 544, fl. 1-74. Karakteristika të studentëve shqiptarë ushtarakë dhe civilë që kanë studiuar në Bashkimin Sovjetik, hartuar nga punonjës të aparatit të KQ të Partisë.

<sup>34</sup> *AQSH*, F. 14/Str, V. 1948, D. 624/2, fl. 1. Letër e Enver Hoxhës, në emër të Komitetit Qendror të PKS-së, drejtuar kryeredaksisë së "Zërit të Popullit", mbi rifillimin e misionit të lartë të kësaj gazete për të propaganduar dhe për të luftuar për zbatimin e përpiktë të vijës së partisë.

<sup>35</sup> *Po aty*. "Zëri i Popullit me të gjitha forcat të shtojë dhe të çelnikosi në zemrat e popullit tonë dashurinë dhe besnikërinë ndaj shpëtimtarit të lavdishëm të popullit tonë Bashkimit Sovjetik, ndaj Partisë së lavdishme bolshevike të Leninit e Stalinit, ndaj

Pushtetin Enver Hoxha nuk do ta mbante me intelektualë, të cilët nuk priste rast për t'i dënuar, por me njerëz ordinerë. Domethënës është fakti se, në vitin 1948, nga burgu i Durrësit u liruan me amnisti një numër të burgosurish ordinerë (në dokument nuk jepet numri i tyre), dhe këta të fundit nuk hezituan t'i shprehnin mirënjohjen Komandantit përmes një telegrami, duke deklaruar se do të vinin të gjitha forcat për forcimin e pushtetit komunist në Shqipëri.<sup>36</sup>

Forcimi i pushtetit haste jo pak vështirësi, pasi grupi i Koçi Xoxes dhe bashkëpunëtorët e tij ishin "zbuluar". Sigurimi i Shtetit duhej të bënte një "piruetë" 180°, duke hedhur poshtë çdo vendim që ishte marrë në kohën e Xoxes. Viti 1948 ishte një vit që solli përmbysje të mëdha për strukturat e kësaj organizate. Sapo përfundoi Plenumi VIII i PKS-së, strukturat e Sigurimit vazhduan identifikimin e çdo individi që mund të bënte pjesë në fraksionin e tradhtarëve të partisë, me në krye Nako Spirun, Liri Belishovën, Fadil Paçramin, Mehmet Shehun.<sup>37</sup> Sipas "logjikës" së Sigurimit, tradhtari Nako Spiru kishte punuar për të minuar partinë nga brenda, ishte zbuluar, ndaj kishte vrarë veten.<sup>38</sup> Po sipas kësaj "logjike" dhe analizës "shkencore" të Sigurimit, fraksioni i Nako Spirit ishte më i rrezikshmi që kishte hasur deri atëherë partia, më i poshtri dhe më i dëmshmi.<sup>39</sup> Madje, aq i rrezikshëm paskësh qenë Nako Spiru sa synonte të godiste unitetin e partisë.<sup>40</sup> Gjuha e përdorur në këtë "analizë" të punës së Sigurimit është jashtë çdo kriteri profesional, ajo shkonte deri në fyerje direkte të personave dhe arrinte në përfundime pa asnjë bazë faktike. Por ç'rëndësi kishte? Plenumi VIII i kishte zbuluar të gjithë

shokut të madh Stalin, të cilëve populli i jonë, dhe Partia e jonë iu detyron fitorjet e kaluara dhe fitorjet e ardhshme. Jeta e popullit tonë dhe e ardhmja e lumtur e tij janë të lidhura deri në vdekje me Bashkimin Sovjetik dhe këtu qëndron sigurimi më i madh që Shqipëria e re, nën udhëheqjen e Partisë s'onë do të eci përpara, do të përparojë dhe do të shkojë në socializëm. Ju uroj suksese në punë. Në emër të Komitetit Central të Partisë, Enver Hoxha. 5 nëntor 1948".

<sup>36</sup> *Po aty*, F. 14/Str, V. 1948, D. 640, fl. 1. Telegram falënderimi nga të burgosur ordinerë, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë, 10 janar 1948.

<sup>37</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme /Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit* (më tej: AMPB/AIDSSH), Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Viti (më tej: V.) 1948, Dosja (më tej: D.) 23, fleta (me tej: fl. 1). Dokument I: Analiza e Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit pas Plenumit VIII të KQ të PKS-së, pa datë. Ky dokument ka 9 fletë me numër rendor 1-9.

<sup>38</sup> *Po aty*.

<sup>39</sup> *Po aty*, fl. 2.

<sup>40</sup> *Po aty*, fl. 6.

armiqtë, të cilët, sipas kësaj logjike, kishin qenë edhe antijugosllavë, edhe antisovjetikë!<sup>41</sup> Dhe, për të vënë qershinë mbi tortë, "analiza" e Sigurimit kishte arritur në konkluzionin se "intelektualët nuk i duheshin partisë".<sup>42</sup>

Pas Plenumit XI, Kongresit I dhe, mbi të gjitha, pas arrestimit të Koçi Xoxes, gjërat ndryshuan si me magji! Duhej të ndreqeshin menjëherë "gabimet" që ishin bërë në kohën e "trockistit" të rrezikshëm Koçi Xoxe. Gara për të treguar besnikërinë ndaj partisë vijoi dhe u bë më e ethshme. Në dokumentin që po analizoj në këtë studim, i hartuar nga Sigurimi i Shtetit, ndodhet edhe një material tepër i rëndësishëm, për të cilin, sipas dijenisë sime, nuk është folur kurrë më parë. Bëhet fjalë për një promemorie të shkruar nga ish-agjenti Vaskë Koleci, i cili ishte arrestuar si pjesëtar i grupit të Koçi Xoxes. Në promemorien e tij, dërguar Enver Hoxhës në vitin 1948 dhe në vitin 1951, ai shkruan me hollësi lidhur me "fajet dhe gabimet që kishte bërë Sigurimi i Shtetit në kohën e Xoxes."<sup>43</sup> Sipas Kolecit, Sigurimi, nën drejtimin e Xoxes, kishte bërë një punë të rëndë antiparti dhe shumë prej metodave që aplikonte kjo strukturë ishin marrë dhe aplikuar nga këshilltarët e Rankoviçit (ministri i Brendshëm jugosllav) të cilin në promemorie ai e quan "xhelat".<sup>44</sup>

Një nga informacionet më të rëndësishme që i nevojitej më së shumti Enver Hoxhës të dinte mbi veprimtarinë e Koçi Xoxes ishte ajo pjesë e memories ku Koleci pohonte se partia ishte nën kontrollin e Sigurimit.<sup>45</sup> Ish-agjenti, tashmë i arrestuar, në këtë promemorie të gjatë përshkruante me imtësi mënyrën se si, me urdhër të Xoxes, strukturat e Sigurimit ishin angazhuar për të vënë nën përgjim dhe kontroll anëtarë

<sup>41</sup> *Po aty*, fl. 10.

<sup>42</sup> *Po aty*, fl. 12.

<sup>43</sup> *Po aty*, fl. 1. Data e promemories me shkrim dore e Vaskë Kolecit është 26 nëntor 1948; shih fletën 14 të këtij dokumenti.

<sup>44</sup> *Po aty*. Pjesë nga promemoria e Vaskë Kolecit: "Nën udhëheqjen e trockistit Koçi Xoxe, me format organizative t'aparitit legal dhe ilegal të marra nga trockistët jugosllavë, me vijën e punës të marrë nëpërmjet materialit të tyre dhe të këshilltarëve të xhelatit Rankoviç si dhe të gjitha këto të aprovuara pa asnjë rezervë, të vëna në zbatim, të zgjeruara dhe të përforcuara nga trockisti Koçi çdo ditë e më tepër, bënë që organet e Sigurimit të krijohen e të vihen në këtë rrugë, ta dëmtojnë rëndë partinë, popullin dhe shtetin tonë të ri, të bëhen një armë e tmerrshme në duart e trockistit Koçi Xoxe për qëllimet e tij të paracaktuara". (Në origjinal shkrimi me italice është i nënvizuar )

<sup>45</sup> *Po aty*.

partie, me justifikimin se "kontrollat bëhen si funksionarë të shtetit".<sup>46</sup> Sipas Kolecit, Xoxe përmes këtyre veprimeve, kishte synuar t'i kthente anëtarët e PKS-së në një detashment partizanësh dhe, për këtë qëllim, kishte përdorur trysinë e ushtruar nga xhelatët e Sigurimit, në një veprimtari në të cilën kishte marrë pjesë edhe vetë. Në fund, ai shprehte pendesë të thellë për dëmin që i kishte shkaktuar partisë.<sup>47</sup>

Metodat për të kontrolluar partinë, Xoxe – sipas Kolecit – i kishte marrë nga këshilltarët jugosllavë, ndër të cilët përmendej më së shumti një kolonel, emrin e të cilit ai nuk e thotë, dhe njëfarë Saret Filipoviç (të cilin nuk e identifikon se çfarë pozite kishte) që në fillim të vitit 1947.<sup>48</sup> Një tjetër e vërtetë e hidhur që Koleci shkruan ishte fakti se "shpata nuk ishte drejtuar vetëm kundër armiqve, por edhe kundër popullit".<sup>49</sup> Në këtë pikë jepet në mënyrë të detajuar se si Sigurimi i kishte ndarë zonat e Shqipërisë në "pro", "kundër", "të dyshimta" dhe "reaksionare". Sipas kësaj teorie, e cila citohet më poshtë, baza ku duhej të mbështetej pushteti komunist do të ishte vetëm Jugu i Shqipërisë.<sup>50</sup>

Sipas Kolecit, arrestimet e kryera nga strukturat e Sigurimit ishin bërë me qëndra dhe shumica e tyre ishin pa baza.<sup>51</sup> Elementi më i rëndë që raporton ish-sigurimi në këtë promemorie ishte se arrestimet e grupit të deputetëve, tekniko-intelektualëve, anëtarëve të Ballit Kombëtar etj., gjatë periudhës 1946-1947, ishin kryer në mënyrë të rrëmbyer dhe pa asnjë bazë ligjore.<sup>52</sup> Tepër e rëndë është edhe pjesa ku Koleci shpjegon se

<sup>46</sup> *Po aty*.

<sup>47</sup> *Po aty*, fl. 3.

<sup>48</sup> *Po aty*, fl. 4.

<sup>49</sup> *Po aty*, fl. 6.

<sup>50</sup> *Po aty*. "Shpata nuk ishte drejtuar vetëm kundra armiqve, por edhe kundra popullit, kjo si rezultat i vijës trockiste për të gjithë sektorët e punës, puna e kontrollit mbi Partinë, Shtetin. Minoriteti shikohesh me syrin shovinist në përgjithësi, pa bërë dallimin, shikohesh me syrin e dyshimit dhe kjo e thënë vetë nga trockisti Koçi. Pjesa e Shqipërisë së Mesme dhe sidomos e Veriut dhe kjo shikohesh me syrin e dyshimit, si kalaja o baza e armiqve (unë vetë kam dëgjuar nga goja e trockistit Koçi që thoshte "Shkodra e reaksionit". Kjo del qartë në ato që do të them më poshtë mbi arrestimet, operacionet e tjera të bëra në këto anë". (Në origjinal shkrimi me italice është i nënvizuar )

<sup>51</sup> *Po aty*.

<sup>52</sup> *Po aty*, fl. 7. "Arrestime të gjera janë bërë me procesin e Sami Qeribashit, Deputetevë, Tekniko Intelktualëve, Ballit Kombëtar e tjera të bëra në 46-47. Këto arrestime janë bërë të rrëmbyera, pa material të vërtetuar; kur doli çështja e deputetëve më 1947, i porositur nga Koçi, u ngrit një komision në krye të të cilit isha unë për të nxjerrë

në Shqipëri, vetëm për një fjalë goje, "futej tjetri brenda".<sup>53</sup> Një tjetër fakt tronditës që jep ai ishte edhe përdorimi i torturave çnjerëzore gjatë marrjes në pyetje të njerëzve, ku mjetet më të përdorura sipas tij ishin "druri, pincat, kamxhiku, litari i lagur, telefoni, jeleku, hekuri i nxehtë, lënia pa ujë, pa bukë, zhveshur, si dhe hekura në trup".<sup>54</sup> Sipas tij, tortura ishte bërë vijë e zakonshme pune në organet e Sigurimit të Shtetit gjatë periudhës kur drejtohej nga Koçi Xoxe. Madje, sipas kësaj promemorie, edhe vetë ky i fundit morri pjesë personalisht në torturimin e personave të arrestuar.<sup>55</sup> Edhe vetë Koleci pranoi se kishte torturuar njerëz së bashku me Nestin (Kerenxhin), por, sipas tij, këto veprime ishin kryer "të nxitur nga lart!"<sup>56</sup> Tepër tronditës është fakti kur Koleci pranoi se, së bashku me Zoi Themelin, nga torturat u kishte vdekur në duar Muzafer Pipa, pasi këtij të fundit i kishin gjetur një letër që ia kishte dhënë Jup Kazazi.<sup>57</sup>

Jo vetëm kaq, por Koleci pranoi se pushkatimet që ishin bërë pa gjyq në Shqipërinë e Mesme dhe veçanërisht në atë të Veriut (p.sh., në procesin e çarmatimit), ishin kryer me qëllim terrorin dhe frikësimin.<sup>58</sup> Sipas tij, shumica e këtyre pushkatimeve, në vitet 1945, 1946 dhe 1947, kishin qenë vrasje ilegale.<sup>59</sup> Ai shton se Koçi Xoxe kishte krijuar edhe një strukturë të posaçme në prokurori për të zhdukur gjurmët e këtyre

informatat që kishin elementët që implikoheshin dhe të bënin propozim për arrestimet".

<sup>53</sup> *Po aty*.

<sup>54</sup> *Po aty*, fl. 9.

<sup>55</sup> *Po aty*.

<sup>56</sup> *Po aty*.

<sup>57</sup> *Po aty*. "Unë kam rrahur në këto raste: Në tetor 1946 kam shkuar për të ndihmuar në procesin e 9 shtatorit në Shkodër që po zhvilloheshe. Që më përpara më kishte thënë shoku Nesti që të rrihim pa u kufizuar. Kur vajta unë një kish vdekur nga të rrahurit. Unë rraha. Kur erdha këtu raportova se në proces i kishin gjetur Muzafer Pipën një dokument që kishte lidhje me Jup Kazazin. Koçi Xoxe në prani të Nestit më tha: e rrihi dhe më dha si të thuash "carta bianca". Kam rrahur aty bashkë me Zoi Themelin, Muzafer Pipën sa vdiq nga druri. I përdora hekurin e nxehtë (kjo e thënë nga Koçi). Vrasjen e maskuam por unë e raportova tek Nesti. Në Shkodër gjithashtu kam rrahur Paulin Palin e tjerë. Këtu në Tiranë kam rrahur me Nestin në procesin e Sami Qeribashit gjithashtu dhe në të deputetëve (Syrja Selfon). Në 1946 kur u zbulua një grup kundërshtar në Vlorë kam rrahur një për pak".

<sup>58</sup> *Po aty*.

<sup>59</sup> *Po aty*, fl. 10.

krimeve dhe për të eliminuar shpejt ata që pushkatoheshin pa gjyq.<sup>60</sup> Madje, sipas tij, detyra e prokurorisë ishte që të "legalizonte" veprimet e Sigurimit.<sup>61</sup>

Sigurimi i Shtetit, nën drejtimin e Xoxes dhe me urdhër të tij, sipas Vaskë Kolecit, kishte vënë në përgjim edhe kuadro të lartë të partisë, duke filluar nga viti 1946. Ndër emrat më të spikatur që përmenden ishin Nako Spiru, Koço Tashko, Spiro Koleka, Manol Konomi, Haxhi Lleshi, por jo Enver Hoxha.<sup>62</sup> Kjo pjesë e promemories lë dyshime të forta për dijeninë e Enver Hoxhës lidhur me përgjimet e zyrtarëve të lartë të PKSH-së, çka do të thoshte se Xoxe e vinte në dijeni për gjithçka.

Në këto informacione rrëqethëse të Kolecit bie në sy edhe një fakt tjetër i rëndësishëm. Instruktorët jugosllavë ishin instaluar në këtë strukturë që në janar të vitit 1945.<sup>63</sup> Sigurimi i Shtetit, në një takim që Xoxe kishte pasur me Josif Pashkon, i kishte thënë se do të kryente funksionet e një "policie politike", e cila do të merrej me kundërshtarët politikë të regjimit dhe jo vetëm.<sup>64</sup> Një nga instruksionet e dhëna nga jugosllavët, sipas Kolecit, ishte që Sigurimi duhej të kishte një rrjet të gjerë informatorësh, në raportin 1/10 sipas proporcionit të popullsisë.<sup>65</sup> Sipas tij, Xoxe i kishte miratuar menjëherë të gjitha instruksionet dhe rekomandimet e jugosllavëve, pa bërë as vërejtjen më të vogël.<sup>66</sup>

Mjaft interesante është pjesa e promemories ku Koleci i quan organet e Sigurimit, në të cilat bënte pjesë edhe vetë, si organe kriminale.<sup>67</sup> Aty ai ripërsërit edhe njëherë atë çfarë kam cituar më lart mbi përdorimin e torturave, edhe pse, siç shkruan vetë, tortura ishte ndaluar me ligj që në vitin 1946.<sup>68</sup> Sipas Kolecit, Koçi Xoxe, edhe pse

<sup>60</sup> *Po aty*.

<sup>61</sup> *Po aty*, fl. 22. "Sipas jugosllavëve seksioni i Sigurimit në Prokurorinë e Përgjithshme s'ishte gjë tjetër veçse një organ i Drejtorisë së Sigurimit dhe që "legalizonte" veprimet e Sigurimit".

<sup>62</sup> *Po aty*, fl. 11. "Për shokun Komandant nuk është thënë asgjë".

<sup>63</sup> *Po aty*, fl. 14.

<sup>64</sup> *Po aty*.

<sup>65</sup> *Po aty*.

<sup>66</sup> *Po aty*, fl. 15. "Koçi të gjitha propozimet e jugosllavëve i ka aprovuar menjëherë pa bërë edhe ndryshimin më të vogël".

<sup>67</sup> *Po aty*, fl. 20. "Organet e Sigurimit = organe kriminale".

<sup>68</sup> *Po aty*. "Që më 1946 është ngritur ndalimi për përdorimin e drurit. Kjo është letër qarkore. Por përsëri është vazhduar edhe tashti më 1948, megjithëse shumë më e kufizuar se më parë".

nuk kishte guxuar të urdhëronte ndonjëherë që të vihej në përgjim Enver Hoxha, përsëri, në pjesën e fundit të promemories së tij e lidhte përgjimin që i bëhej Tuk Jakovës me arsyetimin se ky mund të kishte dokumente "kompromentuese" për kryeministrin.<sup>69</sup> Në fund të letrës prej 27 faqesh me shkrim dore, Vaskë Koleci përpiqet të "sqarojë" pozicionin e tij, duke theksuar se nuk ishte i vetmi që kishte gabuar në vijën trockiste të imponuar nga Koçi Xoxe. Ai përmend edhe emra të tjerë të cilët kishin rënë "pre" e kësaj vije, si Nesti Kerenxhi, por që vijonin të kishin poste me rëndësi në Sigurim, ndërsa ai ishte në burg.<sup>70</sup> Megjithatë, duke qenë se kishte besim të patundur te partia, ai premtonte nga burgju se "do të luftonte gjithnjë për të mbrojtur me besnikërinë më të madhe parimet marksiste-leniniste dhe vijën e drejtë të partisë s'onë heroike".<sup>71</sup>

Dëshmia me shkrim në formën e promemories, dërguar Enver Hoxhës nga Vaskë Koleci, është nga më tronditëset për krimet e Sigurimit të Shtetit në vitet 1945-1948. Sipas vetë promemories dhe deponimeve në hetuesi të Kolecit pas arrestimit, kjo strukturë e frikshme ishte formuar më 10 dhjetor 1944.<sup>72</sup> Edhe pse Koleci ishte munduar të shfajësonte veten, duke përmendur emrin e Nesti Kerenxhit si bashkëpunëtor kryesor në "gabimet" e kryera, me sa duket, për momentin, Kerenxhi "ia kishte hedhur paq", pasi ishte treguar më i shpejtë se vetë Vaskë Koleci, siç do ta shohim më poshtë.

Menjëherë pas përfundimit të Plenumit XI, Kerenxhi i kishte përgatitur Enver Hoxhës një relacion të hollësishëm mbi "gabimet" e Sigurimit të Shtetit, por nuk e ka përmendur në asnjë rresht vijën e gabuar të Koçi Xoxes në drejtimin e kësaj strukture. Ky relacion i Kerenxhit, dërguar Hoxhës, nuk ka datë fikse,<sup>73</sup> ndaj ma vështirësoi

<sup>69</sup> *Po aty*, fl. 23. "Për Komandantin ai s'ka thënë gjë, sepse ka pasë frikë mos dilte në shesh puna e tij, kurse për ata që kish ndënë vehte e bënte ndënë autoritetin si sekretar organizativ dhe gjoja për mbrojtjen e partisë si psh dokumentin për shokun Tuk, që ishte shumë më pak me rëndësi për të. Siç skjarohen punët tashti mundet që Koçi të ketë menduar që ata dokumente "kompromentuese" për shokun Enver janë përsëri në Sigurim. Kështu mund të jetë".

<sup>70</sup> *Po aty*, fl. 26-27. "Disa çështje për t'u skjaruar".

<sup>71</sup> *Po aty*.

<sup>72</sup> *Po aty*, fl. 14. "Organet e Sigurimit janë krijuar më datën 10 dhjetor 1944. Unë jam një nga kuadrot e parë që kam punuar si punëtor i Sigurimit dhe mbi punën e bërë, sidomos në sektorin e brendshëm".

<sup>73</sup> *AMPB/AIDSSH*, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, V. 1948, D. 30, fl. 1. Relacion i përgatitur nga Nesti Kerenxhi, drejtuar Enver Hoxhës pas Plenumit XI më 1948, mbi

punën për të kuptuar nëse ai e ka shkruar pas letrës së Kolecit apo përpara. Megjithatë, mendoj se e ka shkruar përpara letrës së Kolecit, të cilën e analizova më lart, pasi në dokument shkruhet se është përgatitur pas Plenumit XI dhe se vetë Kerenxhi, në letrën e tij me shkrim dore që i paraprin relacionit, e njoftoi Hoxhën se materiali ishte gati për t'u paraqitur në mbledhjen e KQ-së.<sup>74</sup> Për t'i dalë së keqes përpara, ai njoftoi kryeministrin se relacioni ishte përgatitur nga ai vetë, por në konsultime "me shokët sovjetikë".<sup>75</sup>

Në këtë relacion informues, Kerenxhi e quan shpëtim për Sigurimin shtrimin për diskutim në parti të "gabimeve", sepse vetëm në këtë mënyrë kjo strukturë mund të vihej në rrugën e drejtë të partisë.<sup>76</sup> Po ashtu, ai e quajti të gabuar vënien nën vëzhgim të anëtarëve të partisë, pasi Sigurimi nuk kishte asnjë të drejtë të bënte një gjë të tillë.<sup>77</sup> Për të mbrojtur këtë vijë të Sigurimit, ai përpiquej të justifikohej duke thënë se vëzhgimi i anëtarëve të partisë ishte bërë që të mos dyshohej se ata ishin mbi ligjet dhe rregullat e pushtetit popullor.<sup>78</sup> Kerenxhi, gjithashtu, përpiquej të jepte arsyet pse nuk kishte folur më herët, megjithëse vetë anëtarët e Sigurimit e kishin njoftuar qeverinë për të metat e kësaj strukture.<sup>79</sup> Këtë ai e quante tepër të rrezikshme për punën e ardhshme të Sigurimit, sepse, sipas tij, mund të nxiste një urrejtje edhe më të madhe dhe do të mbyllte dyert që partia të mbështeste këtë strukturë aq të domosdoshme për pushtetin.<sup>80</sup> Vijimi i relacionit është një përpjekje e fortë e Kerenxhit për

gjendjen e organeve të Sigurimit të Shtetit, gabimet lidhur me qëndrimin ndaj punonjësve të Sigurimit, si dhe disa propozime për detyrat e organeve të Sigurimit, duke përfshirë nomenklaturën mbi përpunimet, agjenturën, arrestimet, informacionet etj.

<sup>74</sup> *Po aty*.

<sup>75</sup> *Po aty*. "Shoku Komandant, po ju dërgoj atë që përgatita për të shtruar në mbledhjen e K.C. Pjesa e dytë është punuar sipas konsultimeve me shokët sovjetikë".

<sup>76</sup> *Po aty*, fl. 2.

<sup>77</sup> *Po aty*, fl. 3. Pjesë nga relacioni i Nesti Kerenxhit dërguar Enver Hoxhës: "Dolli si gabim i rëndë që ishin vëzhguar anëtarët e Partisë edhe nga ata që e meritonin një gjë të tillë dhe mundet edhe nesër të vëzhgohen. U bë e kurtë se Sigurimi s'ka asnjë të drejtë të përpunojë anëtarët e Partisë. Kjo është e shtrembët".

<sup>78</sup> *Po aty*. "Është e vërtetë që Sigurimi ka bërë gabime të rënda në lidhje me përpunimin e anëtarëve të Partisë, por përpunimi i anëtarëve të Partisë nuk është gabim. Përndryshe del, krijohet opinioni se anëtarët e Partisë janë mbi ligjet dhe rregullat e Pushtetit Popullor".

<sup>79</sup> *Po aty*.

<sup>80</sup> *Po aty*, fl. 4.

të bindur Enver Hoxhën se sa e domosdoshme ishte kjo strukturë për partinë dhe qeverinë.<sup>81</sup> Në fund të relacionit prej dhjetë faqesh të daktilografuara, Kerenxhi kërkoi që të bëhej spastrimi nga radhët e Sigurimit të Shtetit i të gjithë elementëve që kishin gabuar, dhe sidomos i atyre që tregoheshin të ngurtë dhe nuk i "kuptonin" gabimet që kishin kryer.<sup>82</sup>

Fundi i vitit 1948 ishte i mbushur plot e përplot me relacione nga punonjësit e Sigurimit të Shtetit. Ata kishin hyrë në një garë të ethshme për të vënë në dukje të metat që, sipas tyre, ishin konstatuar nga drejtimi i kësaj strukture nga Koçi Xoxe dhe grupi i tij.<sup>83</sup> Thuajse të gjithë agjentët që kishin shkruar letra "shfajësimi" dobësinë më të madhe të punës e shihnin tek arrestimet e kryera pa vend, dhe jo pak herë "kishin hyrë në hetuesi me duar bosh", pra pa pasur asnjë provë.<sup>84</sup>

### **Urdhri i Kryeministrit Hoxha për spastrimin e administratës shtetërore nga "të padëshiruarit dhe armiqtë"**

Dhuna shtetërore e Partisë Komuniste Shqiptare nuk përqendrohej vetëm tek arrestimet dhe dënimet me gjyqe farsë të elementëve kundërshtarë, por edhe te pushkatimet pa gjyq.<sup>85</sup> Një nga metodat e këtyre pushkatimeve ishte rrëmbimi i njerëzve nga banesat në mes të natës, dhe më pas për fatin e tyre nuk dihej asgjë, derisa vinte ndonjë njoftim i organeve të Sigurimit.<sup>86</sup> Këto metoda të Sigurimit për eliminimin e njerëzve pa gjyq kryeheshin sigurisht me urdhër të Koçi Xoxes dhe me aprovimin e Enver Hoxhës. Megjithatë, duke qenë se marrëdhëniet me Jugosllavinë po përkeqësoheshin gjatë vitit 1948, "Komandanti" duhej të dilte i larë nga këto faje, ndërsa e gjithë

<sup>81</sup> *Po aty*, fl. 6-7.

<sup>82</sup> *Po aty*, fl. 10.

<sup>83</sup> *AMPB/AIDSSH*, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, V. 1948, D. 31, fl. 1-5. "Relacion mbi disa gabime në punën operative agjenturale t'organeve të Sigurimit të Shtetit duke i mbështetur kryesisht nëurvejimin dhe hetuesinë, dobësinë e tyre, pasojat që vijnë dhe disa mendime mbi gjendjen e agjenturës, mënyrën e organizimit të punës etj."

<sup>84</sup> *Po aty*, fl. 1. Informacion i nënkolonel M. L., 27 dhjetor 1948.

<sup>85</sup> *AQSH*, F. 14/Str, V. 1948, D. 167, fl. 2-4. "Korrespondencë e Drejtorisë Politike të Ushtrisë dhe Komitetit të Partisë të rrethit Pukë, ardhur në Komitetin Qendror të Partisë, që bëjnë fjalë për disa pushkatime personash pa gjyq nga organet e Sigurimit e Mbrojtjes së Popullit".

<sup>86</sup> *Po aty*.

përgjegjësia duhej të kalonte te ministri i Brendshëm. Në këtë periudhë, informacionet që vinin në Komitetin Qendror të PKSH-së lidhur me situatën në organet e Sigurimit dhe mbi metodat e "gabuar" të përdorura nga ky institucion, të cilat ishin urdhëruar nga Koçi Xoxe, janë të panumërta.<sup>87</sup>

Koçi Xoxe u arrestua dhe u ekzekutua në vitin 1949.<sup>88</sup> Pas ekzekutimit të tij, për organet e Sigurimit të Shtetit filloi një epokë e re nën drejtimin e Mehmet Shehut, i cili e drejtoi këtë organ nga posti i ministrit të Punëve të Brendshme me më shumë vrazhdësi dhe brutalitet sesa paraardhësi i tij. Nën autoritetin e tij, organet e hetuesisë filluan të zbatonin "ligjshmërinë e goditjes", ku, sipas një materiali të hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme, të titulluar "Në dritën e ligjshmërisë", do të justifikoheshin (për aq sa mund të vlente) keqtrajtimet në burgje, veprimet arbitrare etj., të kryera nga organet kompetente ligjzbatuese në vend.<sup>89</sup> Ky material nuk dihet nga kush është hartuar dhe nuk është i firmosur.<sup>90</sup>

Katër vjet pas ekzekutimit të Koçi Xoxes, saktësisht më 24 shkurt 1953, në direktivën nr. 180 me mbishkrimin "Tepër Sekret", Enver Hoxha, në cilësinë e Kryeministrit të Republikës Popullore të Shqipërisë (RPSH), dha udhëzime të posaçme se si duhej të vijonte spastrimi i aparatit shtetëror dhe ekonomik nga elementët e padëshirueshëm, të cilët ai i quante elementë armiq, dhe mbi mënyrën se si duhej të

<sup>87</sup> *Po aty*, F. 14/Str, V. 1948, D. 169. Relacione, letra dhe informacione të ardhura në Komitetin Qendror të Partisë nga Nesti Kerenxhi dhe shokë të tjerë, mbi gjendjen e organeve të Sigurimit pas Plenumit XI, si edhe mbi metodat e gabuar në punën e Sigurimit të Shtetit, të urdhëruara nga Koçi Xoxe; shih edhe *po aty*, F. 14/Str, V. 1948, D. 469. Letër e kapitenit Mit'hat Zaçe, adresuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Shqiptare, lidhur me arrestimin dhe ekzekutimin fshehurazi dhe pa gjyq të Skënder Çelës dhe Mark Toçit nga Durrësi, me urdhër të Koçi Xoxes.

<sup>88</sup> *Po aty*, F. 14/Str, V. 1948, D. 621. "Relacione dhe informacione nga Ministria e Punëve të Brendshme, dërguar shokut Enver Hoxha dhe KQ të PPSH, si dhe korrespondencë mbi këto çështje: Mbi arrestimin dhe burgosjen e Koçi Xoxes, Pandi Kristos, Vaskë Kolecit, Vangjo Mitrojorgjit dhe Myftar Tares".

<sup>89</sup> *Po aty*, F. 14/Str, V. 1949, D. 627, fl. 1-5. "Material nga prokuroria e përgjithshme me titull: "Në dritën e ligjshmërisë" ku flitet: mbi pengesat dhe dëmtimet në plane, veprime të kundraligjshme, keqtrajtime në burg, veprime arbitrare, mbi mungesën e disiplinës nga ana e dikastereve në përgatitjen dhe dërgimin e planeve, mos zbatimin e qarkoreve dhe urdhrave nga ana e komiteteve ekzekutive; dhe mbi neglizhencat në administrimin e pasurisë së shtetit".

<sup>90</sup> *Po aty*, pa firmë, fl. 5-10.

zëvendësoheshin ata.<sup>91</sup> Sipas kësaj direktive, e mbështetur në vendimet e Plenumit V të Komitetit Qendror, ishte dhënë urdhër i prerë për vijimin e spastrimit të aparatit shtetëror, me qëllim që partia të mbetet e pastër.<sup>92</sup> Mungesën e vigjilencës në parti Enver Hoxha ia atribuonte edhe nivelit të ulët kulturor të komunistëve.<sup>93</sup> Udhëheqësi komunist shqiptar kërkonte që, përpara pranimit në administratë, çdo biografi të kalonte në “lupë” dhe të kontrollohej me imtësi; për më tepër, ai synonte një tronditje të të gjithë aparatit shtetëror, në mënyrë që kushdo që punonte aty të jetonte në ethe.<sup>94</sup> Për Enver Hoxhën, çështja e kuadrit duhej të ishte çështje e të gjithë partisë.<sup>95</sup>

Plenumi V i Partisë së Punës të Shqipërisë, i mbajtur në janar të vitit 1953,<sup>96</sup> kishte dhënë alarmin lidhur me "infektimin" e administratës shtetërore nga elementët e padëshirueshëm. Urdhri i Kryeministrit Hoxha për të rishikuar administratën, drejtuar të gjitha degëve të partisë në rrethe, dukej sa absurd, aq edhe i pakuptimtë. Paranoja e udhëheqësit komunist shqiptar për të identifikuar armiq kudo i kalonte të gjitha caqet e arsyes. Enver Hoxha kërkonte vetëm elementë të pastër dhe patriotë, që do të thoshte besnikë të partisë, dhe që komunistët të ishin në krye të administratës. Mbrojtja me vetëmohim e partisë dhe e atdheut – pasi, sipas tij, partia ishte mbi atdheun – konsiderohej detyrë mbi detyrat.<sup>97</sup> Enver Hoxha dha urdhër të prerë që, deri më datë 1 qershor 1953, të pushoheshin menjëherë nga puna në administratë të gjithë ata persona që nuk kishin garanci politike dhe që, sipas tij, ishin armiq të popullit.<sup>98</sup> Po ashtu, duhej të largoheshin menjëherë nga puna të gjithë ata persona që

<sup>91</sup> *AQSH*, F. 14/Str, V. 1953, D. 29, fl. 3. “Mbi spastrimin e aparateve shtetërore dhe ekonomike nga elementët e pa dëshirueshëm dhe armiq dhe forcimin e kontrollit të Partisë mbi organet shtetërore për vendosjen e kuadrit”.

<sup>92</sup> *Po aty*. Sipas Enver Hoxhës, infiltrimi i elementit armik në radhët e administratës kishte ndodhur sepse lufta e klasave nuk ishte ashpërsuar sa duhej dhe komunistët nuk kishin qenë mjaftueshëm të vendosur për të zbuluar dhe goditur armikun e klasës.

<sup>93</sup> *Po aty*, fl. 4.

<sup>94</sup> *Po aty*.

<sup>95</sup> *Po aty*, fl. 7.

<sup>96</sup> *Po aty*, fl. 17/1. “Kryeministria. Tepër Sekret-Personale. Komitetit Qendror të PPSH. Mbi spastrimin e aparateve shtetërore dhe ekonomike nga elementët e padëshirueshëm dhe armiq”.

<sup>97</sup> *Po aty*.

<sup>98</sup> *Po aty*, fl. 17/2.

kishin të afërm në burg, të internuar apo të pushkatuar nga pushteti.<sup>99</sup> Enver Hoxha nuk u ndal me kaq; në cilësinë e kryeministrit dhe sekretarit të parë të partisë, urdhëroi që brenda vitit 1953 të bëhej edhe largimi gradual nga puna i atyre që, sipas tij, nuk ishin besnikë të partisë.<sup>100</sup>

Duke qenë se aparati shtetëror kishte mungesë të theksuar të profesionistëve të kualifikuar, Enver Hoxha urdhëroi që doktorët (mjekët), agronomët, inxhinierët, teknikët e lartë dhe profesorët e shkencave të mbaheshin nën mbikëqyrje, por jo të largoheshin menjëherë nga puna.<sup>101</sup> Dukshëm, në këtë direktivë të ashpër politike, Enver Hoxha "frenohet" disi në goditjen ndaj intelektualëve në administratë, pasi ende nuk kishte formuar klasën e tij të intelektualëve besnikë. Megjithatë, ai nuk mund të lejonte që intelektualët të kishin funksione drejtuese në aparatin shtetëror; sipas tij, ata duhej të kufizoheshin vetëm në detyra profesionale.<sup>102</sup> Enver Hoxha kishte planifikuar me kujdes që të gjithë ata që do të pushoheshin nga puna të mbeteshin vetëm punëtorë të thjeshtë.<sup>103</sup> Degët e Punëve të Brendshme në rrethe duhej të përgatisnin biografinë e çdo personi dhe të ruanin çdo raport mbi ata që përjashtoheshin nga administrata shtetërore.<sup>104</sup> Edhe njëherë, Sigurimi i Shtetit shfaqej si arma kryesore e PPSH-së, duke vepruar si syri dhe veshi i partisë në forcimin e pushtetit.

Arma e Sigurimit duhej të ruhej nga çdo mundësi demaskimi. Për këtë arsye, katër ditë më vonë, më 24 shkurt 1953, urdhrin nr. 180 të datës 20 shkurt, iu shtua një udhëzim i Enver Hoxhës, sipas të cilit elementët e Sigurimit që kishin dhënë informacion mbi biografitë e personave të

<sup>99</sup> *Po aty*, fl. 17/3. "Të pushohen menjëherë nga puna ata të cilëve u janë pushkatuar ose dënuar rëndë me burgim njerëzit e tyre të afërt, nga pushteti ynë. Ata që kanë qenë tregtarë të mëdhenj, pronarë tokash dhe fabrikash, të cilëve u janë konfiskuar pasuritë e tyre dhe qëndrimi i të cilëve pas çlirimit të vendit nuk ka qenë i mirë. Nga kjo kategori mund të mbeten si nëpunësa në funksione të parëndësishme vetëm persona të rrallë, në rast se kanë dhënë prova besnikërie ndaj pushtetit".

<sup>100</sup> *Po aty*, fl. 17/4.

<sup>101</sup> *Po aty*, fl. 17/5.

<sup>102</sup> *Po aty*, fl. 17/6.

<sup>103</sup> *Po aty*, fl. 17/7. "Një person i këtillë mund të punojë si punëtor i thjeshtë, si murator, si marangoz, mund të punojë në kanale, në rrugë, në ndërtime të çfarëdollojshme, në prerje drush në sharra, në ngarkim shkarkim (por jo në porte), etj. Ata nuk mund të merren në punë si shitësa ndër dyqanet e shtetit ose të kooperativave, si magazinierë etj.".

<sup>104</sup> *Po aty*, fl. 17/10.

pushuar nga puna nuk duhej të merrnin pjesë në komisionet e përjashtimit.<sup>105</sup> Në vijim të këtij udhëzimi, më 25 mars 1953, sekretari i Komitetit Qendror, Rita Marko, udhëzoi komitetet e partisë në rrethe që të vepronin me kujdes gjatë aprovimit të kuadrit të ri në administratë, pasi aty mund të rifuteshin elementët armiq të përjashtuar më parë.<sup>106</sup>

Në Komitetin Qendror, zbatuesi më i zellshëm i direktivës nr. 180 të 20 shkurtit 1953 ishte pa dyshim ministri i Brendshëm, Mehmet Shehu. Menjëherë, për të treguar besnikërinë e palëkundur ndaj vijës së partisë, ai filloi goditjet ndaj elementëve antiparti në rrethe, ndër të cilat më e dukshmja ishte ajo në qytetin e Durrësit.<sup>107</sup> Letra e tij informuese mban datën 23 qershor 1953.<sup>108</sup> Goditja u krye ndaj ish-sekretarit të parë të rrethit Nonda Baka, pasi në ditën e vdekjes së Stalinit,\* nuk kishte mbajtur zi, por, sipas raporteve, kishte marrë pjesë në një gosti së bashku me disa komunistë të Durrësit.<sup>109</sup> Absurdi i goditjes fillestare fillon të "trashet", duke nxjerrë "të vërteta" të tjera për ish-sekretarin e parë të rrethit. Sipas Shehut, duke iu referuar një letre të Enver Hoxhës drejtuar Komitetit të Partisë të Rrethit të Durrësit "mbi rrethimin e vendit nga armiqtë e betuar të socializmit"<sup>110</sup>, ish-sekretari i parë i rrethit nuk e kishte zbatuar këtë direktivë. Megjithatë, Nonda Baka u shkarkua për një arsye më të rëndësishme: ai kishte shpërfillur informacionet e Sigurimit të Shtetit që ministri i Brendshëm nuk hezitoi ta quante siç e kishte cilësuar Enver Hoxha në Kongresin I, "arma e mprehtë dhe e dashur e Partisë sonë pse ajo mbron interesat e popullit dhe të partisë kundër armiqtë të jashtëm dhe të brendshëm".<sup>111</sup>

<sup>105</sup> *Po aty*, fl. 17/14. "Në Komisionet e spastrimit t'aparatis shtetëror nuk do të bëjnë pjesë të deleguar të Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit në qendër dhe as oficerë të Degëve të Punëve të Brendshme në rrethe".

<sup>106</sup> *Po aty*, fl. 23.

<sup>107</sup> *Po aty*, fl. 58. "Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH mori edhe një herë në analizë punën e ish sekretarëve të Komitetit të Partisë të rrethit Durrës dhe e konsideron se puna e Nonda Bakës dhe Sami Bylykbashit është një punë armiqësore që e çonte drejt likuidimit organizatën e partisë të rrethit të Durrësit".

<sup>108</sup> *Po aty*, fl. 40.

\* Josif Visarionoviç Stalin vdiq më 5 mars 1953.

<sup>109</sup> *Po aty*.

<sup>110</sup> *Po aty*, fl. 59.

<sup>111</sup> *Po aty*, fl. 61. Mehmet Shehu: "Edhe përsa i përket armës së dashur dhe besnike të partisë dhe popullit, armës së Sigurimit, ish udhëheqja e partisë të rrethit të Durrësit me Nonda Bakën dhe Sami Bylykbashin në krye kanë treguar moskokëçarje për të, bile edhe e kanë nënvleftësuar".

### Identifikimi i "të metave" në punën e Sigurimit të Shtetit

Dy muaj pas ekzekutimit të Berias, më 22 gusht 1953, Enver Hoxha, në një letër me mbishkrimin "Tepër Sekret", iu drejtua të gjithë sekretarëve të partisë në rrethe, si dhe Drejtorisë Politike të Ministrisë së Punëve të Brendshme.<sup>112</sup> Shkak për këtë letër ishte bërë një tjetër letër, po e datës 22 gusht, të cilën vetë Mehmet Shehu ua kishte dërguar drejtorive të Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me "gabimet" në detyrë të organeve të Sigurimit.<sup>113</sup> Me sa duket, letra e Mehmet Shehut – të cilën do ta analizojmë më poshtë – e shqetësoi Enver Hoxhën. Kjo vihet re nga fakti se, në letrën e tij, lideri komunist shqiptar theksonte se

"në përpunimin e kësaj letre duhet të kini parasysh rrezikun e krijimit të një farë frike në punonjësit e Ministrisë së Brendshme dhe në hedhjen e tyre në pasivitet përpara armikut duke u druajtur se mos gabojnë".<sup>114</sup>

Me sa duket, Enver Hoxha ishte frikësuar nga masat që kishte marrë Mehmet Shehu kundrejt disa oficerëve të Sigurimit për "shkelje ligjesh".<sup>115</sup> Në fund të letrës, Enver Hoxha porositi që

"të forcohet kontrolli i partisë mbi organet e punëve të brendshme, me qëllim që organet e punëve të brendshme të jenë kurdoherë syri dhe veshi i partisë".<sup>116</sup>

Po çfarë përmbante letra e Mehmet Shehut që e kishte shqetësuar kaq shumë Enver Hoxhën?<sup>117</sup> Që në fillim të letrës, Mehmet Shehu, pasi

<sup>112</sup> *AQSH*, F. 14/Str, V. 1953, D. 29, fl. 72. "Mbi disa shfaqje të shkeljes së ligjeve nga organet e punëve të brendshme".

<sup>113</sup> *Po aty*, fl. 74. Ministria e Punëve të Brendshme për Komitetin Qendror, Ministrinë e Drejtësisë; Prokurorinë e Përgjithshme; Degët e Punëve të Brendshme të rretheve, si dhe për të gjitha degët operative të Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit dhe Drejtorisë së Policisë Popullore.

<sup>114</sup> *Po aty*, fl. 72.

<sup>115</sup> *Po aty*, fl. 73.

<sup>116</sup> *Po aty*.

<sup>117</sup> Gjon Boriçi, "Pohimi nga Byroja Politike e PPSH të dhunës ndaj të burgosurve dhe internuarve nga organet e Sigurimit të Shtetit deri në vitin 1953", në konferencën shkencore ndërkombëtare *Të mohuar nga regjimi; burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipërinë 1945-1990*, organizuar nga Autoriteti për Informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Tiranë, më 30-31 tetor 2018, përgatiti për botim Sonila Boçi (Tiranë: Albtipografia, 2019), 200.

nxirrte edhe njëherë në pah "tradhtinë" e Koçi Xoxes, nuk hezitonte të shprehte besnikërinë e tij të thellë ndaj Enver Hoxhës.<sup>118</sup> Por, sipas ministrit të Brendshëm, organet e Punëve të Brendshme kishin bërë gabime të rënda, duke shkelur, sipas tij, ligjet e shtetit.<sup>119</sup> Sipas Shehut, rruga e drejtë e eksperiencës sovjetike duhej të ishte triumfuese.<sup>120</sup> Në letrën e tij, Mehmet Shehu evidentonte gabime të rënda, sidomos gjatë hetuesisë, ku në shumë raste ishte përdorur tortura ndaj të burgosurve.<sup>121</sup> Sipas tij, ndër format më të shpeshta të torturës ishin goditja e të burgosurit, zhvillimi i hetuesisë duke e mbajtur të lidhur, shtrëngimi i duarve me hekura përtej normës, prerja e përkohshme e ushqimit, ndalimi i përkohshëm i rrobave të shtresës dhe mbulesës, si dhe mbajtja në këmbë për një kohë të gjatë në hetuesi.<sup>122</sup> Gjithashtu, gjatë arrestimeve nuk ishin respektuar të drejtat legjitime të personave të arrestuar dhe, për shkak të neglizhencës së organeve të Punëve të Brendshme, disa persona ishin mbajtur në burg në kundërshtim me rregullat në fuqi.<sup>123</sup> Për më tepër, ishin shënuar raste të sjelljes arrogante, madje edhe të goditjes me pëllëmbë nga punonjës të Sigurimit ndaj qytetarëve të pafajshëm.<sup>124</sup>

Ndër të tjera, në letrën e tij, Mehmet Shehu rendiste arsyet që kishin çuar në këto gabime, të cilat, sipas tij, përfshinin mungesën e kontrollit të nevojshëm nga ana e organeve superiore, mungesën e kontrollit të partisë mbi veprimtarinë e Sigurimit, mungesën e kontrollit të prokurorive dhe organeve hetuese të Ministrisë së Brendshme.<sup>125</sup> Për të gjitha këto arsye, si dhe për rastet e konstatuara, Ministria e Brendshme, me urdhër të Mehmet Shehut, kishte marrë masat e nevojshme disiplinore dhe penale, deri në arrest me burg ndaj oficerëve të Sigurimit të identifikuar në shkeljet e lartpërmendura.<sup>126</sup> Ai kërkonte që të organizoheshin mbledhje të shpeshta për të evidentuar të gjitha shkeljet në organet e Sigurimit, me qëllim zhdukjen e çdo të mete.<sup>127</sup> Po ashtu, ministri i Brendshëm urdhëronte në mënyrë eksplicite hetuesinë që gjatë

<sup>118</sup> *AQSH*, F. 14/Str, V. 1953, D. 29, fl. 74.

<sup>119</sup> *Po aty*, fl. 75.

<sup>120</sup> *Po aty*.

<sup>121</sup> *Po aty*.

<sup>122</sup> *Po aty*.

<sup>123</sup> *Po aty*, fl. 76.

<sup>124</sup> *Po aty*.

<sup>125</sup> *Po aty*, fl. 76-77.

<sup>126</sup> *Po aty*, fl. 77.

<sup>127</sup> *Po aty*, fl. 78.

marrjes në pyetje të të pandehurve të shmangej çdo lloj torture.<sup>128</sup> Më tutje, Shehu shkruante se "kushdo që do të përdorte torturën që këtej e tutje, në çfarëdo lloj forme qoftë, kundrejt atij do të merreshin masa penale duke ia referuar gjyqit".<sup>129</sup> Më poshtë, ministri i Brendshëm sqaronte se të gjitha arrestimet duhej të kryeheshin nga prokuroria, bazuar në fakte dhe jo në hamendje.<sup>130</sup> Mehmet Shehu tërhoqte gjithashtu vëmendjen se, kur gjykata shpallte të pafajshëm një të burgosur, do të thoshte se arrestimi i tij ishte kryer në baza joligjore.<sup>131</sup> Gjithashtu, një person nuk mund të mbahej më shumë se tri ditë në paraburgim.<sup>132</sup>

Një tjetër fakt interesant në letrën e Mehmet Shehut është edhe pjesa ku sqaronte procedurat e internimeve. Sipas tij, Sigurimi nuk kishte të drejtë të internonte; vetëm Komisioni i Dëbimeve, që ndodhej nën autoritetin e Ministrisë së Brendshme, e kishte këtë kompetencë.<sup>133</sup> Për të internuar një person, kryetari i Degës duhej t'i paraqiste një propozim me shkrim Komisionit të Dëbimeve pranë ministrisë, të argumentuar në mënyrë të hollësishme.<sup>134</sup> Vendimi i Komisionit për internime ose lirime nga internimi ishte i prerë,<sup>135</sup> dhe askush nga punonjësit e Sigurimit të Shtetit nuk duhej ta sfidonte atë. Në rast se dikush nuk ishte dakord me vendimin, ai duhej të njoftonte menjëherë ministrin e Brendshëm.<sup>136</sup>

Internimet ishin një formë tjetër e frikshme dhe e tmerrshme e pushtetit. Abuzimet me to ishin ndër më të rëndat, dhe më poshtë do të ndalemi për t'i analizuar. Sipas Mehmet Shehut, shpesh kërkohesh – dhe realizohej – internimi i një familjeje të tërë, me të gjithë anëtarët, prej 10 apo 15 vetash, ndërkohë që ligjërisht mund të internoheshin vetëm dy ose tre prej tyre.<sup>137</sup> Kjo, sipas Shehut, përbënte një shkelje të rëndë. Anashkalimi i metodës edukative ndaj atyre që bënin gabime apo faje

<sup>128</sup> *Po aty*, fl. 79. "Tortura në çfarëdo lloj forme qoftë, është e ndaluar në hetuesi. Goditja me pëllëmbë ose me grushte, mbajtja në këmbë, prerja e bukës, e gjellës e ujit, ndalimi i rrobave për shtresë e mbulesë, shtrëngimi i duarve me zinxhirë ose hekura e litarë, të gjitha këto konsiderohen tortura dhe janë të ndaluara në hetuesi".

<sup>129</sup> *Po aty*, fl. 80.

<sup>130</sup> *Po aty*.

<sup>131</sup> *Po aty*, fl. 81.

<sup>132</sup> *Po aty*.

<sup>133</sup> *Po aty*, fl. 82.

<sup>134</sup> *Po aty*.

<sup>135</sup> *Po aty*, fl. 83.

<sup>136</sup> *Po aty*.

<sup>137</sup> *Po aty*.

ishite një tjetër mangësi që theksonte ministri i Brendshëm. Puna edukative dhe metodat e partisë kishin munguar ndaj elementëve që mund të ndreqeshin.<sup>138</sup> Kishte edhe raste të tilla, si ai i kryetarit të Degës së Tropojës, i cili nuk kishte urdhëruar internimin e disa dhjetëra familjeve nga ky rreth, edhe pse ekzistonin prova se ato kishin ndihmuar diversantët; përkundrazi, ai i kishte këshilluar ato, me miratimin e Byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit.<sup>139</sup>

Një tjetër faj që evidentonte kontrolli mbi punën e organeve të Sigurimit ishte përvetësimi i pasurive të konfiskuara nga shteti, pa respektuar formalitetet zyrtare dhe ligjore.<sup>140</sup> Enver Hoxha theksonte se "punonjësit e Sigurimit duhet të jenë të pastër si qelibari, të pastër nga të gjitha pikëpamjet".<sup>141</sup> Megjithatë, sipas kësaj letre shumë të rëndë nga zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Brendshme, anëtar i Byrosë Politike, punonjësit e Sigurimit nuk mund të konsideroheshin "të pastër si qelibari". Sjelljet e tyre arrogante, imorale dhe të dhunshme duhej të trajtoheshin si faj i rëndë dhe shkelje të hapura të vijës së partisë dhe të pushtetit.<sup>142</sup> Me këto veprime, Sigurimi nuk mund të ishte i sjellshëm dhe i afërt me popullin, siç e kërkonte partia; ai mbetej vetëm arma më e besueshme e saj, por jo e popullit. Fjala "Sigurim" shkaktonte te populli shqiptar një tmerr me përmasa thuajse apokaliptike.

Një tjetër fakt që vuri në dukje Mehmet Shehu ishin shfaqja e sjelljeve imorale nga punonjësit e Sigurimit. Sipas tij, imoraliteti ishte i palejueshëm, dhe çdo veprim i tillë i punonjësve operativë ndaj grave bashkëpunëtore, apo grave të paraburgosura ose të burgosura, përbënin një faj të rëndë dhe të pafalshëm.<sup>143</sup> Ministri i Brendshëm kërkonte gjithashtu ashpërsi dhe jo oportunitizëm nga punonjësit e Sigurimit ndaj kulakëve, edhe nëse ata mund të ktheheshin në bashkëpunëtorë.<sup>144</sup> Sigurimi i Shtetit duhej t'i përmbahej pa mëdyshje platformës së aprovuar

<sup>138</sup> *Po aty*.

<sup>139</sup> *Po aty*, fl. 83-84.

<sup>140</sup> *Po aty*, fl. 84. "Pasuria e shtetit është e paprekshme dhe duhet të mbrohet e jo të shpërdorohet nga organet tona. Vjedhja, shpërdorimi, abuzimi, dëmtimi i pasurisë së shtetit, duhet të konsiderohet si një faj jashtëzakonisht i rëndë kur ky kryhet nga punonjës të Ministrisë së Brendshme, mbasi punonjësit e Ministrisë së Brendshme kanë si funksion kryesor ruajtjen e pasurisë së shtetit".

<sup>141</sup> *Po aty*, fl. 84-85.

<sup>142</sup> *Po aty*, fl. 85.

<sup>143</sup> *Po aty*, fl. 86.

<sup>144</sup> *Po aty*, fl. 86-87.

nga Byroja Politike e Komitetit Qendror, sipas së cilës sekretarët e organizatave bazë të partisë nuk mund dhe nuk duhej të ishin punonjës të Sigurimit të Shtetit.<sup>145</sup> Me sa duket, privilegjet që gëzonin punonjësit e Sigurimit ishin aq të mëdha, sa kërkesat për t'u bërë pjesë e këtij organi ishin të shumta. Vetë Mehmet Shehu e pranoi këtë një muaj e gjysmë më vonë, gjatë një autokritike të sforcuar, të cilën do ta analizojmë gjerësisht më poshtë.

Jo pak herë, lidhjet mes një punonjësi të Sigurimit dhe një bashkëpunëtori, anëtar partie, kishin sjellë pasoja negative për shumë njerëz. Mehmet Shehu theksonte se kjo lidhje nuk ishte një lidhje partie, e destinuar për të denoncuar qëndrimet e individëve në organizatat bazë, por ishte një lidhje thjesht operative kundër armiqve.<sup>146</sup> Sipas Shehut, interpretimi i drejtë i kësaj lidhjeje, përbënte bazën e suksesit në luftën kundër armiqve të partisë dhe të popullit, forconte ligjshmërinë e organeve të Sigurimit dhe siguronte kontrollin e plotë të partisë mbi to, përfundonte ministri i Brendshëm në letrën e tij informuese.<sup>147</sup>

### **Përfundime**

Nuk mendoj se Enver Hoxha dhe Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH-së do të kishin pohuar dhe pranuar dhunën e ushtruar ndaj të burgosurve dhe të internuarve, po të mos kishte ndodhur rënia dhe ekzekutimi i Berias në Bashkimin Sovjetik. Fryma e re politike, e iniciuar nga Nikita Hrushovi pas marrjes së pushtetit në krye të BS-së, patjetër që ndikoi edhe në udhëheqjen shqiptare. Në të gjithë Europën Lindore, ndryshimi i lidershit në Bashkimin Sovjetik shënoi fillimin e një qasjeje të re ndaj komunizmit dhe marrëdhënieve me aleancën perëndimore.

Vitet 1947-1953 ishin vendimtare për ndryshimet në strukturën e Sigurimit të Shtetit. Vdekja e Stalinit e tronditi thellë Enver Hoxhën. Lideri komunist shqiptar e ndiente se era e ndryshimeve që po frynte në Bashkimin Sovjetik dhe në mbarë Lindjen komuniste do ta prekte, herët a vonë, edhe atë vetë personalisht. Figura më e rëndësishme pas Enver Hoxhës, pas eliminimit të Koçi Xoxes, ishte pa dyshim Mehmet Shehu. Duke drejtuar strukturën më të rëndësishme të shtetit shqiptar dhe mekanizmin kryesor me anë të të cilit mbahej pushteti – Sigurimin e

<sup>145</sup> *Po aty*, fl. 87.

<sup>146</sup> *Po aty*, fl. 88.

<sup>147</sup> *Po aty*, fl. 90.

Shtetit – Shehu ishte shndërruar në figurën simbol të dhunës dhe të terrorit të kësaj arme. Rritja e autoritetit dhe e prestigjit të tij në të gjitha strukturat shtetërore, si edhe përgjegjësitë e shumta shtetërore e politike që mbante, e bënin Mehmet Shehun një rrezik potencial për Enver Hoxhën, veçanërisht në rast se pushteti do të ndryshohej "me urdhër" nga Bashkimi Sovjetik.

Rënia dhe ekzekutimi i Berias ishte një shenjë e qartë për Enver Hoxhën për të goditur Mehmet Shehun. Është e vështirë të besohet se Hoxha nuk ishte i informuar për veprimet e Sigurimit, përfshirë abuzimet dhe torturat. Mbledhja e Byrosë Politike dhe pranimi i dhunës në burgje dhe kampe internimi mund të kishte ndodhur shumë më herët, që pas eliminimit të Koçi Xoxes, por kjo nuk u bë.

Në mbledhjen e Byrosë Politike të datës 28-29 shtator 1953, Mehmet Shehu ndodhej në një pozitë tepër të vështirë, ku mund të pritej shkarkimi, arrestimi dhe, rrjedhimisht, ekzekutimi, njëlloj siç ishte vepruar më 23 qershor 1953 me Berian, në mbledhjen e Byrosë Politike të Partisë Komuniste të BS-së.<sup>148</sup> Shehu nuk pati fatin e Berias, pasi u tregua i shpejtë për "të vajtuar" hallin e tij tek ambasadori sovjetik në Tiranë. Edhe pse ai bëri një autokritikë të hapur për dhunën që ushtronin punonjësit e Sigurimit në burgje dhe kampe, dhuna ndaj të persektuarve u strukturua vetëm paksa, por nuk u ndal. Regjimi komunist shqiptar nuk reshti kurrë së ushtruar dhunë, si ndaj popullit në përgjithësi, ashtu edhe ndaj kësaj shtrese të vuajtur në veçanti. Pranimi i krimeve të Sigurimit ndaj të burgosurve, të internuarve dhe popullit shqiptar në tërësi nuk solli asnjë ristrukturim të regjimit të Enver Hoxhës. Përkundrazi, në vendimin nr. 443 të datës 2 nëntor 1953, Enver Hoxha<sup>149</sup> kërkonte që Sigurimi të vazhdonte të funksiononte si syri dhe veshi i partisë në luftën kundër armiqve. Kritikkat që Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH-së mund t'i bënte Sigurimit nuk duhej në asnjë mënyrë të dobësonin vigjilencën ndaj luftës së klasave dhe ndaj armiqve të pushtetit popullor. Pushteti duhej të ruhej me çdo kusht, madje edhe me çmimin e mijëra viktimave të tjera – të pushkatuar, të burgosur, të internuar ose të izoluar. Për Enver Hoxhën, e vetmja gjë e rëndësishme ishte pushteti i tij absolut; gjithçka tjetër ishte e parëndësishme.

<sup>148</sup> Boriçi, "Pohimi nga Byroja Politike e PPSH", 215.

<sup>149</sup> Po aty, 216.

## Burime e bibliografi:

### Arkiva:

*Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)*

Fondet:

- F. 14/Arkivi i Partisë - Strukturat (Str), 1948, 1949, 1953

*Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme/Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë (AMPB/AIDSSH), 1948*

### Literaturë historiografike:

BERGMAN, Jay. *Meeting the demands of reason; the life and thought of Andrei Sakharov*. New York: Cornell University Press, 2009.

BORIÇI, Gjon "Një vështrim në terma politiko-ekonomikë ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë në periudhën 1945-1949 (Pjesa e dytë, korrik 1947 – mars 1948), në *Studime historike*, nr. 2 (2023): 133-155.

*Të mohuar nga regjimi; burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipërinë 1945-1990*. Organizuar nga Autoriteti për Informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Tiranë, më 30-31 tetor 2018.

GURAKUQI, Romeo. *Shqipëria dhe Tokat e Lirue me 1939-1946*. Botim i dytë i rishikuar. Tiranë: Jozef, 2023.

## ASSOC. PROF. DR. GJON BORIÇI

Institute of History / Academy of Sciences of Albania

Gjon.Borici@akad.gov.al

### *S u m m a r y*

THE DIMENSION OF THE WAR WITHIN USING THE STATE SECURITY DURING THE COMMUNIST REGIME IN ALBANIA IN THE PERIOD 1947-1953

To understand what was the duty of the Sigurimi in order to preserve the communist power and to annihilate the so-called enemies of the regime

requires a deep understanding of Albania's situation during the first years of the Cold War and the situation of the country and the communist leadership after the rift with Yugoslavia and the "surrender" to the arms of the Soviet Union. It is not easy to understand why the Albanian communist leadership and specifically the supreme leader of the country Enver Hoxha needed so much to undertake "deep cleansing" of the Sigurimi structures time after time. The most essential cleansing of these structured occurred in above mentioned years, 1948 and 1953. This because in the Socialist Camp happened spectacular turmoil, from the Stalin-Tito rift to the execution of Beria. It was not unimaginable that Enver Hoxha and his closest entourage would do the utmost to preserve the power by liquidating all those who were distinguished as "loyal" figures of the "excommunicated" and falling leaders in Socialist Camp. The falling of the main leaders of the Sigurimi structures was accompanied with a long and painful declaration what they have done, how people were tortured, killed and evaporated with no trace within few hours. The research within of the archives sheds light that the main "deeds" that the structures of Sigurimi have done, were made possible to know from what have said during the processes of interrogation of the former members, accusing each other of these crimes.

**Keywords:**

Albania, State Security, hit, Enver Hoxha, Mehmet Shehu, Koçi Xoxe, eliminations.

